

Nr. 5017 Prot.

Nr. 1 Prot.

Tiranë, më 17/06/2025

Tiranë, më 17/06 2025

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E lidhur sot më datë, 17.06.2025, midis palëve :

1. “SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR”, me adresë : Rruga e Durrësit, nr.83, Tiranë, me NIPT: J72216003P Përfaqesuar nga Znj. REME XHOLI, në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm; Dhe
2. FONDACIONI “ONE HEART CHILDREN”, me seli ligjore në Tiranë dhe me adresë Rr. “Gramoz Pashko”, e njohur dhe regjistruar si person juridik në bazë të Vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor nr. 1012 datë 12/12/2024, si dhe me ndryshimet e tjera përkatëse të depozituara në regjistrin e OFJ-ve të kësaj Gjykate, përfaqësuar nga Znj. Engjela Xhelio, në cilësinë e Drejtore, Ekzekutuve

### Baza ligjore

Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligji 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, V.K.M. 135 dt. 07.03.2018, “Për miratimin e statutit të Shërbimit Social Shtetëror”, Ligji 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, Ligji 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” si dhe bazuar në Rregulloret e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të institucioneve pjesë e kësaj marrëveshje.

### Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i marrëveshjes është bashkëpunimi i ndërsjelltë ndërmjet Fondacionit “One Heart Children” dhe Shërbimit Social Shtetëror për implementimin e programit të themeluar nga fondacioni “Gjyshet për fëmijët” për përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve të braktisur, të institucionalizuar si dhe pasurimin e gamës së shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve.

Dispozitat e kësaj marrëveshje do të interpretohen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

### Neni 2 Objekti i Marrëveshjes

Zbatimi i programit “Gjyshërit për fëmijët” nga fondacioni “One Heart Children” dhe aplikimin e këtij projekti inovator në interesin më të lartë të fëmijës.

Në vijim të kësaj marrëveshje bashkëpunimi, institucionet e varësisë të përzgjedhura nga SHSSH për

zhvillimin e këtij programi do të lidhin marrëveshje të veçantë, me qëllim bashkëpunimin dhe koordinimin, në bazë të vullnetit të palëve.

Programi “Gjyshet për fëmijët” do të implementohet në tre institucione nën administrimin dhe kordinimin e Shërbimit Social Shtetëror:

- Shtëpia e Foshnjes nga 0 -5 vjeç “Hana dhe Rozafa”, Tiranë
- Shtëpia e Fëmijëve Shkollorë 6-15 vjeç “Zyber Allulli”, Tiranë
- Shtëpia e të Rinjëve 16-18 vjeç, Shkodër

### Neni 3

#### Përgjegjësitet e “SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR”

Sigurimin dhe garantimin e hapësirës institucionale si dhe kushteve të nevojshme për zhvillimin e programit.

Dhënien në dispozicion të të gjitha informacioneve të nevojshme brënda kuadrit ligjor, për identifikimin e nevojave të fëmijëve.

Angazhon stafet e çdo institucioni pjesë e projektit të bashkëpunojnë për realizimin e programit.

Rekrutojnë dhe përzgjedhin stafin, duke ju referuar legjislativit për fëmijët, ligjit dhe rregullores me të cilën funksionon SHSSH.

### Neni 4

#### Përgjegjësitet e FONDACIONI “ONE HEART CHILDREN”

Trajnojnë stafin e përzgjedhur “Gjyshërit” të gatshëm për punë me fëmijë.

Implementon dhe ndjek progresin e programit përmes stafit të tij.

Krijon raporte të përbashkëta pune me SHSSH.

Angazhohen për të zbatuar me përpikmëri politikat për mbrojtjen e fëmijëve.

### Neni 5

#### Objektivat e Marrëveshjes

Palët bien dakord për:

- 3.1 Krijimin e një strehe të ngrohtë familjare me praninë e figurës së gjyshes.
- 3.2 Ofrimin e kujdesit të vazhdueshëm të personalizuar nga figura familjare e gjyshërvë.
- 3.3 Angazhimin dhe krijimin e aktiviteteve dhe lojrave të ndryshme me fëmijët.
- 3.4 Mbështetjen emocionale dhe shoqërore të fëmijëve vunerabël me qëllim rrithjen e vetëbesimit tek fëmijët.
- 3.5 Ofrimi i mundësive me qëllim eksplorimin e formave të artit si dhe formave të tjera të shprehjes krijuese tek fëmijët.
- 3.6 Përforcon vëmëndjes individuale (mardhënia një-për-një) për secilin fëmijë.
- 3.7 Ofrimin e mbështetjes së specializuar për fëmijët me nevoja të veçanta.

**Neni 6**  
**Angazhimet e palëve**

- 4.1 Palët bien dakort të bashkëpunojnë në projekte duke qënë të hapura për partnership dhe nisma të përbashkëta që kontribuojnë kryesisht në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve përfshirë fëmijët.
- 4.2 Shërbimit Social Shtetëror i lejon aksesin fondacionit "One Heart Children" në institucionet e varësisë me qëllim zhvillimin e programit të sipërcituar.
- 4.3 Fondacioni "One Heart Children" merr përsiper realizimin e programit të projektit si dhe implementimin e tij në institucionet e fushës së veprimit.
- 4.4 Në angazhimin dhe trajnimin vullnetar të gjyshëve.
- 4.5 Implementimin, zbatimin dhe mbikqyrjen e efektivitetit të programit.
- 4.6 Raportim të ndërsjellë mbi zbatimin e programit.

**Neni 7**  
**Konfidencialiteti**

1. Gjithë informacioni, duke përfshirë informacionin personal që përbahet nga Palët në lidhje me këtë Marrëveshje, trajtohet si konfidencial. Asnjë informacion personal nuk do t'i komunikohet ndonjë pale të tretë pa miratimin paraprak me shkrim të palës së interesuar.
2. Palët duhet të respektojnë Parimet e Mbrojtjes së të Dhënave në rast se ata mbledhin, marrin, përdorin, transferojnë ose ruajnë të dhëna personale gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.
3. Çdo Palë, nuk do të përdorë logot e Palës tjetër dhe /ose të Donatorit për aktivitete të përbashkëta pa marrëveshje paraprake me Palën dhe/ose Donatorin përkatës.

**Neni 8**  
**Kohëzgjatja dhe disponueshmëria**

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi lidhet përfshirë një periudhë 1 (*një*) vjeçare, me të drejtë rinovimi.
2. Secila nga palët mund të përfundojë këtë Marrëveshje duke njoftuar më shkrim 1 (*një*) muaj përpëra palën tjetër.

**Neni 9**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Çdo mosmarrëveshje, kundërshtim apo pretendim që rrjedh nga/ose në lidhje me këtë Marrëveshje, apo rastet e shkeljes, ndërprerjes apo pavlefshmërisë së saj, do të zgjidhet në mënyrë miqësore nëpërmjet negocimit mes Palëve.
2. Në rast se mosmarrëveshja, kundërshtimi apo pretendimi nuk është zgjidhur me negociata brenda 2 (*dy*) muajsh nga marrja e njoftimit nga njëra palë përfshirë ekzistencën e një mosmarrëveshjeje, kundërshtimi ose pretendimi të tillë, secila palë mund të kërkojë që mosmarrëveshja ose kërkesa të zgjidhet pranë organeve kompetente.

**Neni 10**  
**Dispozitat e fundit**

1. Palët angazhohen të respektojnë këtë marrëveshje për të gjithë kohëzgjatjen e parashikuar në Nenin 8 të saj;
2. Marrëveshja mund të ndryshohet apo rinovalohet me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve, nëpërmjet një dokumenti me shkrim të nënshkruar nga secila palë;
3. Kjo marrëveshje bashkëpunimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga palët. Ajo hartohet në 5 kopje të barazvlefshme, nga tre kopje për fondacioni dhe dy për SHSSH.

**SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR**

Reme XHOLI

**DREJTOR I PËRGJITSHËM**



**FONDACIONI “ONE HEART CHILDREN”**

**Deborah DUSHKU**

**PRESIDENTE FONDACIONIT**

**Erjola XHEKO**

**DREJTOR EKZEKUTIV**

